REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2023:090141

Datë: 22.01.2024

Numri i dokumentit: 05224020

P.nr.98/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË/DEGA NË DEÇAN - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetëm gjykues Armend Lokaj, me sekretaren juridike Sabiha Hoxha, në çështjen penale, kundër të pandehures V.F., për shkak të veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.Nr.1657/2022, të datës 07.04.2023, pas shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Arlinda Nallbani - Gacaferri, dhe e pandehura V.F., me datë 19.01.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **22.01.2024**, përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

V.F., nga i ati J....., e ëma Z..., e gjinisë K...., e lindur më datë ...., në D...., tani me vendbanim në Rr."A.... A...", Hy-.-., nr. ... në F.... K...., e gjendjes së mesme ekonomike, e pa martuar, ka të kryer fakultetin ekonomik, punon si këshilltare në projektin "USAID", me numër personal ....., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

Me datën 22/07/2022, rreth orës 11:30, në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Belegut, Komuna D.... ka ushtruar aktivitet të jashtëligjshëm minerar në kundërshtim me pjesën e V (pestë), të Ligjit për Miniera dhe Minerale 03/L-163 si dhe Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr.03/L-163, me ç 'rast bën degradimin e tokës në pronësi publike, pa pejen përkatëse, në atë mënyrë që ditën kritike gjatë inspektimit të terrenit të bërë nga ana e zyrtarëve (pylltarëve) në kuadër të DAPK, konstatohet se e pandehura me forcë mekanike ka bërë gërmimin e sipërfaqes tokësore me dimensione 9 x 10 metra, me qëllim të parapërgatitjes së bazamentit për ndërtimin e objektit, me këto veprime ka bërë degradimin ose shkatërrim të mjedisit si dhe ka prishur strukturën e tokës, gjendje kjo e konstatuar nga pylltari pranë DAPK – së, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

2023:090142

- Me këtë ka kryer veprën penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4; 7; 38; 40; 43; dhe 69 të KPRK-së dhe neneve 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurën:

E GJ Y K O N

Të pandehurës: V.F., i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej **300€** (tre qind euro), të cilin dënim më gjobë është i obliguar t'a paguaj në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'a zëvendësoj me dënim me burg, ku **një (1) ditë** burgim do të llogaritet me **20 (njëzet)**, euro gjobë.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) €**, si dhe në emër të kompensimit të fondit për viktima, shumën prej **30 (tridhjetë)** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi**.**

E dëmtuara: **Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës** në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.Nr.1657/2022, të datës 07.04.2023, e ka akuzuar të pandehurën V.F., për shkak të veprës penale Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit nga neni 338 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.16.01.2024, ku në seancë kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Arlinda Nallbani - Gacaferri, dhe e pandehura V.F..

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur me dt. 16.01.2024, Prokurori i shtetit lexoi aktakuzën PP/II.Nr.1657/2022, të datës 07.04.2023, dhe menjëherë të pandehurës i'u dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet e pafajshme.

E pandehura në shqyrtimin fillestar, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi, me vullnet të plotë dhe e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën i vihet në barrë duke deklaruar se kërkoj falje për veprimet e mija, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla.

2023:090142

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga e pandehura, i njëjti është bërë në mënyrë të plotë dhe konform dispozitave ligjore. Pasi që e pandehura e pranojnë fajësinë, ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës, unë mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik dhe i propozoj gjykatës që të pandehurën ta shpallë fajtore dhe ta dënoj sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari gjykata në bazë të nenit 242 par. 6 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, me aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga e pandehura pasi që është bindur plotësisht se e pandehura ishte e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pandehura e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e saj të plotë.

Nga thëniet e vet të pandehurës në shqyrtimin fillestar është vërtetuar se ajo me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e akuzës së ngritur ndaj saj, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklarimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga e pandehura, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehures, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtën pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjëse.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurës gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: e pandehura e ka pranuar fajësinë, e pa dënuar më parë, kërkim falja dhe se premtimi se në të ardhmen nuk do të përsëris më vepra penale, ndërsa rrethanë renduese nuk ka gjetur, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me gjobë.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par. 3, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 39 par. 3, pika 31.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit – 05/L036.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marr duke u bazuar në nenin 462 të KPPK – së.

2023:090142

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË/ DEGA NË DEÇAN - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.98/23, dt.22.01.2024.

Sekretare juridike **Gjyqtari i vetëm gjykues**
Sabiha Hoxha **Armend Lokaj**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjet (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.